

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN GOLEM, KAVAJË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Golem, Kavajë**, me objekt: “*Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fondet publike, taksat dhe tarifat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimit e asetëve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, etj*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 77, datë 30.06.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 305/8, datë 30.6.2014, i ka rekomanduar z. Agron Agalliu Kryetar i Komunës, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të merren masa të plota organizative e ligjore për zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm nga të cilat, 17 masa për shpërbllim dëmi të pa zbatuara me vlerë 11,713 mijë lekë dhe 6 masa në proces për shpërbllim dëmi, në vlerë 13,592 mijë lekë.

Brenda muajit Dhjetor 2014.

2. Të hartohet plani për ngritjen e sistemit dhe kontrollit, si dhe metodologjia për zbatimin e tij, të hartohet dhe të miratohet Kodi Etik, të identifikohet dhe të krijohet regjistri i riskut, të implementohen dhe të aplikohen procedurat antikorrupsion etj, në zbatim të nenit 8, 10, 12, 20 etj, të ligjit 10,296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”.

Brenda muajit Shtator 2014

3. Autoriteti kontraktor të rishikojë, të ripunojë dhe të reflektojë në projektpreventivët e tenderëve “*Ndërtimi i nënkalimit hekurudhor Golem*” dhe “*Mbingritja e linjës hekurudhore te nënkalimi hekurudhor te Komuna Golem*”, për saktësimin e zërave të punimeve dhe volumit që e kanë të përbashkët, me qëllim uljen e vlerës së tyre.

Brenda muajit Shtator 2014

4. Autoriteti kontraktor të marrë masat e nevojshme teknike organizative me qëllim përfundimin punimeve në tenderët me “*Asfaltimi i rrugës hyrëse qendër – plazh Golem*”, “*Nënkalimit hekurudhor*” dhe “*Mbikalimit hekurudhor*”, sipas afateve të përcaktuara në DST dhe kushteve të fitimit të tyre.

Brenda muajit Shtator 2014

5. Komuna Golem të hartoj një strategji të zhvillimit ekonomik dhe sektorial, duke ngritur ekipet përkatëse të menaxhimit të saj dhe të marrë në konsideratë këto dokumente për hartimin e PB-it dhe PBA-së.

Brenda muajit Shtator 2014

6. Zyra e Financës në bashkëpunim me Zyrën e Planifikimit të Territorit dhe të Shërbimeve, gjatë përgatitjes së projektbuxhetit korrent dhe projektbuxhetit afatmesëm, të parashikojnë detyrimet afatshkurta ndaj të tretëve, të cilat në fund të vitit 2012 janë 31,216,109 lekë, kurse në fund të vitit 2013 rezultojnë 46,377,976 lekë.

Në vazhdimësi

7. Të ngrihet ekipi i menaxhimit të programit i cili është përgjegjës për nxjerrjen e një plani të hollësishëm për tre vitet e procesit planifikues buxhetor afatmesëm që përputhet me prioritetet e politikave dhe i përballueshëm brenda tavanit, për monitorimin e ecurisë gjatë vitit ushtrimor.

Brenda muajit Shtator 2014

8. Në hartimin e Projekt Buxheteve Afatmesme të mbahen parasysh inkurajimi i efektivitetit, eficientes dhe ekonomicitetit në kryerjen e shpenzimeve, të ketë lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet prioriteteve strategjike me shpërndarjen e burimeve dhe kryerjen e shpenzimeve, promovimin e disiplinës fiskale, duke mundësuar që shpenzimet të planifikohen brenda një kuadri realist.

Në vazhdimësi

9. Zyra e Financës:

- Të përgatit një dokument ku të përshkruaj organizmin dhe procedurat kontabël, i cili është i nevojshëm për kuptimin e sistemit të trajtimit të informacionit kontabël dhe të kryerjes së auditit.
- Të saktësojë sipas analizave aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe aktivet qarkulluese, në mbështetje të inventarizimit fizik, si dhe të rivlerësojë aktivet e qëndrueshme, në zbatim të dispozitave ligjore të fushës.
- Të marrë masa për informatizimin e veprimeve me magazinimin e mallrave dhe ruajtjen e tyre, me qëllim që të ndiqet gjurma e konsumit apo e amortizimit.
- Të krijoj regjistrin e aktiveve të qëndrueshme, ku të pasqyrohen të dhënat e nevojshme si data e hyrjes, vlera e blerjes, vlera e shpenzimeve të mirëmbajtjes, amortizimi i akumuluar etj, në zbatim të kërkesave të Kap. III-të të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- Të marrë masa konkrete duke koordinuar punën me strukturat përkatëse, në drejtim të arkëtimit të “kërkesave të farkëtueshme mbi debitorët”, e cila në fund të vitit 2013 është *91,599,589 lekë*.

Në vazhdimësi

10. Komuna të marrë masa e nevojshme për regjistrimin në ZVRPP Kavajë, të gjithë objektet që ka në administrim dhe sipas VKM-^{ve} që kanë bërë kalimin në inventar, në përputhje edhe me ligjin nr. 33/2012, datë 29.4.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”.

Brenda muajit Shtator 2014

11. Zyra e Planifikimit të Territorit të hartojë regjistrin e planifikimit të territorit me të dhënat për tokën, projektaktet dhe aktet e planifikimit, kërkesat për zhvillim dhe lejet e zhvillimit, të ndërtimit apo të përdorimit, si dhe studime apo materiale të tjera me interes për publikun, në zbatim të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”.

Brenda muajit Shtator 2014

12. INUV të organizojë punën dhe të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore, me qëllim arkëtimin e shumës prej 4,800,000 lekë, e cila përfaqëson vlerën e gjobave në 16 raste, si dhe të ndjekë procedurat përkatëse penalizuese, për objektet ndërtimore me parregullsi në dokumentacionin e lejes së ndërtimit.

Në vazhdimësi

13. Të merren masat e nevojshme organizative për evidentimin, programimin dhe arkëtimin e taksës mbi tokën bujqësore, e cila për vitin 2012 dhe 2013 është 9,574 mijë lekë gjithsej.

Brenda muajit Dhjetor 2014

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të merren masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **144,964,549 lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë:

1. Komisionit të vlerësimit të ofertave të përbërë nga zj. D.Q., B.K., P.P. G.I. dhe H.B., vlerë **2,451,000 lekë**, e cila përfaqëson rritjen e padrejtë të vlerës së tenderit, për shkak se vlerësimet e

kryera prej tyre në tenderin me objekt “Hartimi i instrumenteve vendore të planifikimit të territorit” për Komunën Golem, në renditjen e OE dhe shpalljen e fituesit, janë të papajtueshme me kërkesat specifike të vendosura në Kriteret e Veçanta të Kualifikimi të Dokumenteve Standarde të Tenderit, si dhe përcaktimet e parashikuara në nenin 1 "Objekti dhe qëllimi", të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

2. Për 13 punonjës të komunës (pasqyra nr. 1) vlerën **724,046 lekë**, e cila përfaqëson:

- 268,606 lekë pagesa për punë jashtë kohës normale, në kundërshtim e cila përfaqëson pagesa të kryera për pagesa të kryera për punë jashtë kohës normale, në kundërshtim me VKM nr. 463, date 16.06.2011, “Për disa ndryshime dhe shtesa ne vendimit nr. 511, date 24.10.2002 i ndryshuar,

- 319,440 lekë pagesa të kryera për punonjësit me arsim të mesëm, në kundërshtim me pikat 18, 19 dhe 20/6 të VKM nr. 1619, datë 02.7.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të Qeverisjes Vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të Qeverisjes Vendore” i ndryshuar,

- 136,000 lekë paguar për emërim në funksion, në kundërshtim me nenit 25 pika 1/a e ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”.

3. Operatorit ekonomik “E...” sh.p.k. vlerën **3,175,392 lekë**, e cila përfaqëson vlerën e përfituar për punime të pakryera, në tenderin me objekt “Ndërtimi i nënkalimit hekurudhor Golem”, në kundërshtim me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar.

4. Z. A.K. dhe F.Sh., vlerën **9,068,465 lekë**, e cila përfaqëson rritjen e padrejtë të vlerës së tenderit, për shkak se në cilësinë e hartuesve të projektpreventivit në tenderin me objekt “Mbingritja e linjës hekurudhore te nënkalimi hekurudhor te Komuna Golem” kanë vendosur çmime në kundërshtim me *VKM nr. 407, datë 27.6.2012* “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, si dhe për shkak të rritjes së volumit të punimeve në preventiv, mbi volumin e punimeve që justifikohen nga projekti.

5. Komisionit të vlerësimit të ofertave të përbërë nga z. A.Q., B.K., H.B. dhe L.B. vlerën **299,400 lekë**, e cila përfaqëson vlerën e sigurimit të kontratës, për shkak se në tenderin me objekt “*Blerje 2 makina teknologjike*”, kanë kualifikuar dhe shpallur fitues subjekti, “T...” sh.p.k. në kundërshtim me kriteret e përcaktuara KVK dhe në DST.

6. Subjektit ndërtues “E...”sh.p.k. vlera **440,219 lekë**, e cila përfaqëson mos kryerjen e pagesës për taksën e ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 51, të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar.

7. OE “M...E...” sh.p.k. vlerën **51,460 lekë**, e cila është shtuar padrejtësisht në situacionin e punimeve për “Dekoracionin e fundvitit” në strukturën e kostos, në kundërshtim me udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 për “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

8. Z. A.A., në cilësinë kryetarit të komunës vlerën **480,000 lekë**, e cila përfaqëson pagesën e kryer një juristi të jashtëm për përfaqësim në gjykatë, në kushtet kur komuna e ka në strukturë dhe të punësuar, një punonjës jurist .

9. OE “E...” sh.p.k. vlerën **47,583,000 lekë**, e cila përfaqëson shumën e moszbatimit të penaliteteve për 549 ditë vonesa, në tenderin me objekt *“Ndërtimi i nënkalimit hekurudhor Golem”*.

10. OE “E...” sh.p.k. vlerën **1,854,000 lekë**, e cila përfaqëson shumën e moszbatimit të penaliteteve për 86 ditë vonesa, në tenderin me objekt *“Mbingritja e linjës hekurudhore te nënkalimi hekurudhor te Komuna Golem”*.

11. OE “B...X” sh.p.k. vlerën **9,918,819 lekë**, e cila përfaqëson shumën e moszbatimit të penaliteteve për 179 ditë vonesa, në tenderin me objekt *“Sistemim asfaltim i rrethrotullimit Qendër – Plazh Golem”*.

12. OE “S...” sh.p.k. vlerën **3,527,695 lekë**, e cila përfaqëson shumën e moszbatimit të penaliteteve për 231 ditë vonesa, në tenderin me objekt *“Sistemim Unaza e re – Bulevardi i Palmave”*.

13. OE “T...” sh.p.k. vlerën **798,400 lekë**, e cila përfaqëson shumën e moszbatimit të penaliteteve për 40 ditë vonesa, në tenderin me objekt *“Blerje dy makineri teknologjike”*.

14. OE N...” sh.p.k. vlerën **72,510 lekë**, e cila përfaqëson shumën e moszbatimit të penaliteteve për 4 ditë vonesa, në tenderin me objekt *“Sistemim rruga e Avdive”*.

Veprimet e përshkruara në pikën 8, 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14, janë në kundërshtim me nenin 34 të shtojcës 14 *“Kushtet e përgjithshme të kontratës”* të DST, si dhe nenit 34, 35, 36 dhe 37 të kontratës lidhur midis palëve.

15. Trembëdhjetë Shoqërive të ndërtimit (sipas pasqyrës bashkëlidhur nr. 2) vlerën **1,461,000 lekë**, nga e cila për vitin 2012 vlerën 210,000 lekë dhe vitin 2013 vlerën 1,251,000 lekë, që përfaqëson taksën e pastrimit dhe gjelbërimit të pa llogaritur dhe arkëtuar, në kundërshtim me nenin 33 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për Sistemin e Taksave Vendore”* i ndryshuar, VKK nr. 2 datë 02.02.2012.

16. Vlerën **3,326,004 lekë**, për **129** subjekte që ushtrojnë aktivitet në territorin e Komunës (pasqyra nr. 3 bashkëlidhur), për të cilët nuk janë llogaritur dhe vendosur gjobat për vitin 2013, në kundërshtim me nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për Procedurat Tatimore”* i ndryshuar.

18. Vlerën **336,635 lekë**, për 10 subjekte që ushtrojnë aktivitet në territorin e Komunës (pasqyra nr. 4 bashkëlidhur), të cilët nuk kanë deklaruar për vitin 2013 dhe nuk ju është bërë njoftim vlerësimi tatimor nga zyra, në kundërshtim me neni 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për Sistemin e Taksave Vendore”* i ndryshuar.

19. Vlerën **745.504 lekë**, për 7 subjekte (pasqyra nr. 5 bashkëlidhur) që ushtrojnë aktivitet në territorin e Komunës, nga e cila për vitin 2012 në vlerë *74,430 lekë* dhe vitin 2013 në vlerë *671,074 lekë*, për të cilët nuk është llogaritur/arkëtuar detyrimi tatimor për taksën e fjetjes në hotel, taksën e ndërtesës, taksën e pastrimit, gjelbërimit etj, në kundërshtim me nenin 22, 24, 26, 35, etj të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 i ndryshuar.

C. MASA ADMINISTRATIVE.

I. Për Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

Mbështetur në nenin 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, që për shkeljet e ligjshmërisë në ndërtim dhe konkretisht për shkelje të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, shkelje të VKM nr. 407, datë 27.6.2012 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ndryshuar me VKM nr. 92, datë 19.2.2014 Kreu VII, “Sanksione” pika 1 shkronja (a), *i rekomandojmë* Komisionit të dhënies së licencave, pranë Ministrisë Zhvillimit Urban dhe Turizmit, të vendosë sanksionet si më poshtë:

- Heqjen e licencës për një afat prej 1 (një) viti, për mbikëqyrësin e punimeve të ndërtimit:

1. Z. A.K.,

2. Z. F.Sh.

Për shkeljet e konstatuara në procedurën e zbatimit të tenderit me objekt:

- “Ndërtimi i nënkallimit hekurudhor Golem” me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik në vlerën **3,175,392 lekë**, e cila përfaqëson pagesa të përfituara për punë të pakryer, në papajtueshmëri me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

- “Ndërtimi i mbingritjes linjës hekurudhore te nënkallimi Komuna Golem” me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik në vlerën **9,068,465 lekë**, e cila përfaqëson rritjen e vlerës së preventivit, fondit limit të tenderit në kundërshtim me projektin e miratuar dhe VKM nr. 407, datë 27.6.2012 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”.

- Mos llogaritjen e penaliteteve për vonesat në përfundimin e punimeve në zbatim të kushteve të kontratës lidhur midis palëve, kundrejt OE “E...” sh.p.k. me 489 ditë vonesa dhe “E...M” sh.p.k. me 86 ditë vonesa.

II. Për Inspektoratin Ndërtimor Vendor.

Në mbështetje të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, Kreu III-të “Sanksionet” neni 15, Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor, të vendosë gjobë për mbikëqyrësin e punimeve të ndërtimit:

1. Z. A.Q., për shkak të mos llogaritje të penaliteteve për vonesat në përfundimin e punimeve OE “S...” sh.p.k, me 231 ditë vonesa, në zbatim të kushteve të kontratës lidhur midis palëve, në tenderin me objekt Sistemim, asfaltim dhe rikonstruksion i Infrastrukturës rrugore unaza e Re “Bulevardi i Palmave –deri tek piketa 6”.

2. Zj. M.T., për shkak të mos llogaritje të penaliteteve për vonesat në përfundimin e punimeve, OE “B...X” sh.p.k, me 179 ditë vonesa, në zbatim të kushteve të kontratës lidhur midis palëve, në tenderin me objekt “Sistemim, asfaltim rreth rrotullimi qendër – Plazh Golem”.

III. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve neni 27, 28 dhe 29, i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të

evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalin nr. 6 dhe 7, datë 24.4.2014, vërejtjeve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenin 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” të ndryshuar, pikës 3, kreu X të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, neni 7, pika 2,3/a, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, i **rekomandojmë Drejtorit të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për 3 anëtarët e Komisionit “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, si më poshtë:**

1. Zj. N.Sh. në cilësinë e kryetares së komisionit të prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël,

2. Z. S.K. në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël,

3. Z. H.B. në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël për shkak se:

- Nuk kanë kryer prokurim me vlerë të vogël në transaksionet me urdhër shpenzimi nr. 54, datë 19.03.2012, nr. 32, datë 24.01.2013 dhe nr. 67, datë 19.03.2013, në kundërshtim me Kreu VI, të VKM-së nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe UKM nr. 1, datë 01.02.2013 “për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar.

- Kanë lejuar copëzimin e fondeve për artikuj dhe grup artikuj në tre raste me vlerë 1,700 mijë lekë, duke çuar në shmangien e procedurave të prokurimit në kundërshtim me nenin 28 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

D. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenin 37 dhe 153 pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 10 dhe 11 të kontratës individuale të punës, i kërkojmë Kryetarit të Komunës, që bazuar në nenin 44 germa “i” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

“Zgjidhje e kontratës së punës” për:

1. Z. R.A., me detyrë Përgjegjës i Policisë së Komunës, për mos përmbushje të detyrave funksionale në pajtueshmëri me ligji nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës” i ndryshuar, Urdhrin e përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003 dhe Ministrit të Rendit Publik, nr. 823, datë 11.04.2003 “Për miratimin e rregullores “TIP” të policisë bashkiake dhe të Komunës”.

Mbështetur në nenin 37 dhe 153 pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe nenin 11 të kontratës individuale, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës” për:

2. Zj. N.Sh. me detyrë përgjegjëse e Zyrës së Financës pasi:

- Nuk ka parashikuar në projektbuxhetin korrent dhe afat mesëm detyrimet afatshkurta ndaj të tretëve, të cilat në fund të vitit 2012 janë 31,216,109 lekë, kurse në fund të vitit 2013 rezultojnë 46,377,976 lekë.

- Nuk ka përgatitur një dokument ku të përshkruaj organizmin dhe procedurat kontabël, i cili është i nevojshëm për kuptimin e sistemit të trajtimit të informacionit kontabël dhe të kryerjes së auditit.

- Nuk ka saktësuar sipas analizave aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe aktivet qarkulluese, në mbështetje të inventarizimit fizik. Nuk ka rivlerësuar aktivet e qëndrueshme, në zbatim të dispozitave ligjore të fushës, si dhe nuk janë marrë masa për informatizimin e veprimeve me magazinimin e mallrave dhe ruajtjen e tyre, me qëllim që të ndiqet gjurma e konsumit apo e amortizimit.
- Nuk ka marrë masa për të kryer inventarizimin fizik të aktiveve të qëndrueshme në pronësi, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimit të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- Nuk ka krijuar regjistrin e aktiveve të qëndrueshme, në të cilin të pasqyrohen të dhënat e nevojshme si data e hyrjes, vlera e blerjes, shpenzimet mirëmbajtjes, amortizimi i akumuluar etj, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011.
- Nuk ka kontabilizuar në dhjetë raste, ngurtësimin e fondeve në formën e garancisë, për cilësinë e punimeve të kryera gjatë vitit 2012.

3. Z. H.B. dhe

4. z. L.H., në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim në objektin: “Blerje makineri teknologjike për largimin e mbetjeve urbane”, për shkak se nuk kanë llogaritur, ndaluar dhe kontabilizuar penaltetet për lëvrim të vonuar të mallrave, në zbatim të nenit 5 të kontratës lidhur midis palëve.

5. Zj. D.Q., me detyrë përgjegjëse e Zyrës Urbanistikës për shkak se:

- Nuk ka hartuar regjistrin e planifikimit të territorit me të dhënat për tokën, projekt-aktet dhe aktet e planifikimit, kërkesat për zhvillim dhe lejet e zhvillimit, të ndërtimit apo të përdorimit si dhe studime apo materiale të tjera me interes për publikun, sipas përcaktimeve të kreut V të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”.
- Nuk ka apeluar në të gjitha shkallët e gjykimit vendimet gjykatës së rrethit Gjirokastrë me nr. (2010-4344) 2483 datë 30.09.2010, nr. (11-2011-666) 353 datë 10.02.2011, nr (11-2013-3444) 1788 datë 28.06.2013, nr.(11-2013-408) 204 date 25.01.2013 dhe nr.(11-2012-4641) 1528 date 01.06.2012.
- Nuk janë në përputhje me vendimet e KRRT -së komunës Golem nr. II/46, datë 10.07.2004 me nr. II/61, datë 08.02.2006, lejet e ndërtimit nr. 3396, datë 24.10.2012 dhe nr. 104/1, datë 10.05.2013.

6. Z. L.B. me detyrë përgjegjës,

7. Z. B.Xh. me detyrë specialist,

8. Zj. B.L. me detyrë specialiste,

9. Z. E.K. me detyrë inspektor i taksave,

10. Z. N.R. me detyrë inspektor i taksave,

11. Z.XH.I. me detyrë inspektor i taksave, në Zyrën e Tatim – Taksave,

për parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara, në kundërshtim me nenin 61,70, 80, 91, 114, 118 dhe 122, germa b, e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nenin 4 dhe 35 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” etj.

D. KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281, me shkresën nr. 305/16, datë 11.9.2014 kemi bërë

kallëzim penal duke dërguar për veprime të mëtejshme procedurale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë:

1. Z. A.A. mr detyrë Kryetar i Komunës Golem

2. Z. E.L. me detyrë ish-Krye/inspektor i INUV

Nga Komuna Golem Kavajë, me shkresë protokolluar në KLSH me nr. 305/13 datë 30.7.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **ku rezulton se rekomandimet janë pranuar pjesërisht dhe zbatuar po pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Fatmir Zilja, Shefki Jaupi, Julian Adili, Din Zeneli dhe Xhemal Luka, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT